

Analiza vjetore 2022, për Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Në kuadër të programit të analizës vjetore për vitin 2022, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua Analiza Vjetore e Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja për vitin 2022.

Këto analiza kanë për qëllim reflektimin mbi përmbushjen e objektivave kryesorë të institucionit si dhe punës audituese të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe për gjenerimin dhe propozimin e ideve të reja mbi përmirësimin e punës audituese.



Hapja e Analizës vjetore për vitin 2022, u krye nga Drejtori i Departamentit z. Rysisim Xhaja, i cili në mënyrë të përmbledhur foli për risitë dhe ndarjet në dy sektorë të Departamentit si dhe plotësimi i vakancave me Auditues të rinj të specializuar në fusha të ndryshme që mbulon Departamenti. Gjithashtu ai u ndal në auditimet e kryera, duke analizuar gjetjet e kryera nga audituesit si funksionimi i subjektit, dëmi ekonomik shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit, mënyra e përdorimit të fondeve, etj., si dhe në mënyrë të përmbledhur fenomenet që hasen më shpesh në auditimin e subjekteve.

Më pas fjalën e mori kryeaudituesi z. Jonild Hoxhaj, i cili mbulon Sektorin e auditimit të Investimeve të Huaja ku foli për veprimtarinë audituese të sektorit që mbulon për vitin 2022.

Duke i lënë hapësirë pyetjeve dhe diskutimeve, fjalën e mori kryeaudituesi z. Fatmir Iliazi, i cili mbulon Sektorin e auditimit të Shoqërive Publike, ku foli për veprimtarinë audituese të sektorit që mbulon për vitin 2022 si dhe për auditimin e ushtruar në subjektin Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Më pas fjalën e morën dy auditues z. Erald Kojku, i cili foli mbi auditimin e kryer në Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a., në cilësinë e përgjegjësit të grupit ku analizoji auditimin e kryer dhe dukuritë e gjetura në atë auditim dhe z. Alfred Leskaj, i cili foli mbi auditimin e kryer pranë Shoqërive Publike me tematikë “Performanca e shoqërive publike të sektorit energjetik në administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Analiza vjetore për vitin 2022, pas pyetjeve dhe diskutimeve të audituesve pjesëmarrës, u mbyll me fjalimin nga Drejtori i Departamentit z. Rysisim Xhaja, me caktimin e objektivave për vitin 2023, sfidat që na presin dhe planin e auditimeve për vitin 2023.